

SI TË MBROHEMI NGA VALA E TË NXEHTIT?

Rekomandime për udhëheqësit e institucioneve për kujdes për personat e moshuar dhe të qendrave për kujdes afatgjatë institucional



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Shëndetësisë



ISHP INSTITUTI I MAJKEŠISË SË PUNËS
I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT - SHKUP

MASA AFATSHKURTRA PËR ZVOGËLIMIN E TEMPERATURËS NË DHOMË GJATË PERIUDHËS SË TË NXEHTIT

MASA

Vendosja e termometrave të cilët e matin temperaturën e brendshme (të dhomës)

Siguroni hije

Ventilatorë

Ventilatorë të cilët spërkatin ujë

Pajisje të kondicionerit

KOMENTET

Është e dobishme të monitorohet rregullisht temperatura në ambientet e brendshme dhe të merren masa të përshtatshme për ta rregulluar atë.

Vendosja e grilave (roletave) në anën e jashtme të dritareve e ul ndikimin e nxehtësisë së diellit. Vendosja shtesë e pëlhurave mbrojtëse në anën e brendshme e përmirëson efektin.

Ventilatorët mund të ofrojnë lehtësim, por kur temperatura është mbi 35°C, ventilatorët nuk janë efektivë.

Efekti ftohës i ventilatorëve që spërkasin ujë është më i madh edhe në temperatura më të larta, në krahasim me ventilatorët e zakonshëm.

Kondicionerët sigurojnë ambiente më të freskëta. Përdorni kondicioner që është efikas në aspektin e konsumit të energjisë. Pastrimi dhe mirëmbajtja e duhur janë shumë të rëndësishme për funksionimin korrekt të kondicionerit dhe për të shmangur ndikimet e dëmshme mbi shëndetin. Merrini parasysh ndërprerjet e mundshme të energjisë elektrike gjatë periudhës së verës!

